

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 28 PRILL 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Teksa sot diskutojmë të drejtën tuaj të informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, mijëra prej jush kanë filluar tashmë të hyjnë dhe të aksesojnë në shërbimet që ofron platforma e shërbimeve publike e-Albania. Në fund të kësaj dite, siç edhe dje, 2000 prej jush do të kenë marrë gati 50 mijë shërbime. Ndaj dhe raporti i Komisionerit sot është një nga raportet më të rëndësishme për sa u përket këtyre dy të drejtave tuaja themeltare, të drejtës për t'u informuar dhe të drejtës për të pasur të dhëna personale të mbrojtura. Qeveria duket se e ka ndarë mendjen.

Dje Kryeministri njoftoi publikisht se më 30 prill, në fund të këtij muaji, mbyllen të gjitha sportelet. Me sa duket, në garën dhe në presionin e revolucionit teknologjik qeveria ka vendosur të ndërtojë të gjitha shërbimet publike me në qendër, në zemër të shërbimeve publike, qytetarin, pra të gjithë ju që doni t'i merrni shërbimet më lirë, më shpejt, më mirë. Për sa kohë që secili nga ju hap telefonin dhe merr shërbime nga Google-i, nga Amazon-i dhe nga Netflix-i, patjetër që ushtrohet i njëjti presion për të marrë shërbime nga administrata publike. Të dhënat thonë se, teksa aksesoni telefonin tuaj për një shërbim publik apo për një shërbim privat, kuintilion, që, në mos gaboj, është një numër me 30 zero, të dhënat merren nga ju, nga secili prej nesh dhe grumbullohen qoftë në kompani private, qoftë në serverë shtetërorë.

Nuk ka më mirë se institucionet shtetërore si garantuese të mbrojtjes së të dhënave tuaja personale. Ndaj edhe raporti i sotëm i Komisionerit është një nga raportet më të rëndësishme. Pra, ndërsa qeveria i ka përmbushur detyrat e saj duke ofruar shërbime të gjindshme për qytetarët, shërbime inovative dhe efektive për ta, ne, si Kuvend, kemi një detyrë: të ushtrojmë kontroll kushtetues ndaj organit të Komisionerit, i cili është një nga siguresat kryesore për të ruajtur të dhënat personale dhe për të ruajtur të drejtën e secilit prej jush për të marrë informacione. Sot Komisioneri solli një sërë shqetësimesh.

Madje, muaj më parë, disa prej nesh u ngarkuan nga ky Kuvend për një nga fenomenet më të shëmtuara e më të rrezikshme që ka ndodhur në demokracinë tonë digjitale, atë të rrjedhjes së informacionit, për të cilën Komisioneri, në ushtrim të plotë të detyrës së tij, me përgjegjshmëri, në zbatim të ligjit, ka

hetuar administrativisht, siç thotë në raportin e tij, këto subjekte: Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Partinë Socialiste të Shqipërisë, Partinë Bindja Demokratike dhe portalin Lapsi.al; ka lënë detyra, ka lënë rekomandime, ka gjetur shkelje të ligjit, por, gjithashtu, ka gjetur edhe nevojën për përmirësim. Të vetmit persona, të vetmit zyrtarë, të vetmit shtetarë, të cilët kanë braktisur detyrën dhe nuk e kanë ushtruar atë, ishin kolegët tanë, të cilët kërkuan hetimin dhe kontrollin e këtij fenomeni. Me mijëra faqe janë në Kuvendin e Shqipërisë dhe presin të hetohen dhe të kontrollohen, pra ne të ushtrojmë kontrollin tonë parlamentar, sepse është e vetmja mënyrë për të mbajtur demokracinë digjitale në funksionim.

Për ta mbyllur, teksa qeveria u ofron qytetarëve shërbime më të lira, më të shpejta dhe më të mira, kolegët tanë të opozitës duhet të ndahen njëherë e mirë nga praktika e braktisjes së detyrës, nga momenti i monitorimit të qytetarëve teksa protestonin, të cilët, pasi i vranë, fshinë edhe serverin. Pra, kjo praktikë ka marrë fund njëherë e mirë, ndaj qytetarë ju ftoj të vazhdoni të ushtroni kontrollin tuaj mbi ne, në mënyrë që ne të ushtrojmë kontrollin tonë mbi organet e ngritura për të zbatuar ligjin. Faleminderit!